

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Bombardime izraelite në Liban, 13 të vrarë, mes tyre gjashtë fëmijë - Informohu siç duhet
ADRESA	https://radar.al/bombardime-izraelite-ne-liban-13-te-vrare-mes-tyre-gjashte-femije/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 15:32:05 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 15:05:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ac999b69ca76e967b5a39aefc0b75a565c88bf126b854bc6807af19dde9f8803
TEKSTI	c6e334840b190c86a18da2456d08a0cce23e55c8dc80c5e01c9080e54f1dbe26
PAMJA	3339e8ffd455b3aa0bc62a87c12a49cc33e1d21e62c6001c7273d591d37a40df

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4e3fc8353863a3b0ea0f494ba2a767cc1887de513f9f87d8279d4ad23cd1ef58
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c5c495e1993bed01ae9e3c22701c0f0e7f56228ef65729414d07abaefa87f787
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4e3fc8353863a3b0ea0f494ba2a767cc1887de513f9f87d8279d4ad23cd1ef58>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

YOU ARE AT: Home » Bombardime izraelite në Liban, 13 të vrarë, mes tyre gjashtë fëmijë

BOTË

Demo

Bombardime izraelite në Liban, 13 të vrarë, mes tyre gjashtë fëmijë

SEPTEMBER 14, 2026



Të paktën 13 persona, mes tyre gjashtë fëmijë dhe tre gra, kanë humbur jetën në sulmet ajrore izraelite në qytetin Kfar Ruman, në jug të Libanit. Ministria libaneze e Shëndetësisë e konfirmoi bilancin, duke e cilësuar ngjarjen si një nga sulmet më vdekjeprurëse të javëve të fundit.

Sulmet kanë rikthyer shqetësimet për nisjen e një fushate të re ushtarake izraelite në Liban, në një kohë kur tensionet janë rritur ndjeshëm gjatë ditëve të fundit, pavarësisht armëpushimit të arritur në qershor për t'i dhënë fund luftimeve mes Izraelit dhe Hezbollahut.

Sipas dëshmimeve nga vendngjarja, një kompleks banesash u godit në orët e para të mëngjesit, ndërsa fëmijët po përgatiteshin për të shkuar në shkollë. Gazetarët e Reuters që ndodheshin në zonë raportuan se në mesin e rrënojave u gjetën edhe libra shkollore, ndërsa ekipet e shpëtimit përdorën makineri të rënda për të nxjerrë viktimat nga ndërtesa e shembur.

Një prej rasteve më tragjike është ai i tetëvjeçarit Mustafa Farhat. Sipas banorëve, fëmija ka humbur nënën dhe gjyshërit në bombardim, ndërsa ekipet e shpëtimit vijnë kërkimet për babain e tij. Vetë Mustafa ndodhet në spital me lëndime.

Një e afërme e familjes, Mona Farhat, tha për Reuters se shtëpia u godit pak para hapjes së shkollave. "Çfarë synojnë? Cili është objektivi i tyre? A duan që ne të largohemi nga toka jonë? Gabohen", u shpreh ajo.

Ushtria izraelite deklaroi se objektivi i sulmit në Kfar Ruman ishin persona që, sipas saj, mbanin armë. Izraeli gjithashtu tha se po hetonte raportet sipas të cilave në sulm mund të ishin goditur edhe civilë.

Sipas autoriteteve libaneze, në një tjetër incident një dron izraelit që kishte në shënjestër një automjet vrau një ndihmës mjekësor dhe plagosi dy persona të tjerë.

Sulmet u kryen pa një paralajmërim paraprak për evakuim nga ushtria izraelite, sipas raportimeve nga vendngjarja.

Nga ana tjetër, ushtria izraelite pretendoi se gjatë natës Hezbollahu kishte lëshuar dy dronë të armatosur në drejtim të trupave izraelite pranë kreshtës Ali al-Taher, në një zonë kodrinore të Libanit juglindor ku, sipas Izraelit, grupi militant ka ndërtuar një kompleks ushtarak nëntokësor.

Javën e kaluar, Izraeli deklaroi se kishte "pastruar" zonën nga luftëtarët e Hezbollahut. Grupi libanez nuk ka bërë koment lidhur me këtë pretendim.

Postimet e reja

Bombardime izraelite në Liban, 13 të vrarë, mes...

SEPTEMBER 14, 2026

Kurti paralajmëron krizën: Jemi pranë zgjedhjes së...

SEPTEMBER 14, 2026

Ilir Meta del nga kafazi i qelqtë, Apeli pranon...

SEPTEMBER 14, 2026

Babai i Andy Burnham ndërron jetë pas betejës...

SEPTEMBER 14, 2026

Mos e humb

AKTUALITET | SEPTEMBER 14, 2026

Skema sesi IUTE zbras fitimin nga Shqipëria, që ju merr konsumatorëve me interesa mbi 30%!

Vitin e kaluar lute në Shqipëri pagoi 1.1 miliardë lekë ose 11.4 milionë euro shpenzime...

Skandal me sallamin në dyqanet Conad, thirrje konsumatorëve ta kthejnë mbrapsht**6 milionë euro të Startup Albania: Përfutjesit, qokat dhe "problematikët"****Beralb fitoi 15 mln euro nga bakri shqiptar, por po helmon fshatra të tërë me ndotje**

Na ndiq

Facebook

Instagram

YouTube

TikTok

SHARE.

RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A

Email: radarlajme@gmail.com

Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

Universi ka një surprizë për këto 3 shenja më 14 shtator

Një ditë me surpriza në dashuri: Horoskopi për të gjitha shenjat

Pak dramë, shumë ndjenja: Horoskopi i dashurisë për këtë javë



Aleanca për
Media
Etike

Artikull joetik?

[raporto këtu](#)

© Radar.al, dizenuar nga 1001solutions

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.